



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 mars 2021

Nr.ref.:RK1732/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI13/20

Parashtrues

Hidajet Canziba

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0032-A0001 të 26 dhjetorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hidajet Canziba, nga Komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-I-17-0032-A0001] e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS), të 26 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartcekur përmes të cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 17 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 23 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 29 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia kërkoj kopjet e vendimeve gjyqësore që lidhin me rastin tij. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS.
8. Më 6 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi kopjet e vendimeve gjyqësore që ndërlidhen me rastin tij.
9. Më 18 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës pretendon se babai i tij I.C., ka qenë pronar i pronës së kontestuar [Nr. 904-0] dhe tashmë kërkon që të fitojë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kontestuar, bazuar në të drejtën e trashëgimisë nga babai tij.
11. Më 10 janar 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) dhe kërkoi: (i) vërtetimin e të drejtës se pronësisë mbi ngastrën [Nr. 904-0]; (ii) të detyrohet AKP-ja që t’ia njeh dhe t’ia lejojë regjistrimin e pronës së kontestuar në emrin tij.
12. Gjatë zhvillimit të procedurave në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, AKP-ja paraqiti kundërshtimet dhe propozoi që padia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e papranueshme, pasi që nuk ekziston ndonjë provë që do të vërtetonte se prona e kontestuar ishte regjistruar në të kaluarën në emër të paraardhësit të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 4 korrik 2016, Zyra e Kadastrave e Komunës së Rahovecit pas kërkesës së Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, paraqiti historinë e pronës së kontestuar ku vërtetoi se prona e kontestuar është privatizuar në vitin 2015 dhe është regjistruar si pronë private në emër të “SHPK NTP Eurokos”.
14. Më 25 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS përmes Aktgjykimit [C-III-14-0003] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se prona e kontestuar nuk është regjistruar në emër të parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht parashtruesit i mungon legjitimiteti pasiv.
15. Më 31 janar 2017, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të lartcekur dhe kërkoi që ky i fundit të anulohet.
16. Më 10 shkurt 2017, DHPGJS i kishte dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore por pa sukses.
17. Më 26 dhjetor 2019, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-17-0032-A0001] në pajtim me nenin 253, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (në tekstin mëtejme: LPK) e vlerësoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të tërhequr, me arsyetimin se ky i fundit nuk ka paguar taksën gjyqësore dhe as nuk ka paraqitur kërkesën për t’u liruar nga taksa gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS, me vendimin e kontestuar ka shkelur nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] dhe 46 (Mbrotjtja e pronës) të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Aktgjykimi i shkallës së dytë, Kolegji të Apelit është si me qenë ndonjë formular i lëshuar nga gjendja civile. Taksën nuk e paskam paguar. Gjykata ka mund të e inkasoj me dhunë. Me nenin*

253.4 të LPK-së thuhet se padia mundë të trajtohet e tërhequr. Ma kanë trajtuar të tërhequr dhe ky veprim shkel garancionin e të drejtës për qasje në drejtësi”.

20. Përfundimisht, parashtuesi kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin [AC-I- 17-0032-A001] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, të 26 dhjetorit 2019.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuar me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

23. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashikohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

1.“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2.Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...].”

24. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-17-0032-A0001] të 26 dhjetorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
25. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmerisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmerisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Gjykata rikujton se në substancë pretendimi kryesor i parashtguesit të kërkesës është shkelja e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i mos-shqiptimit të një aktgjykimi nga DHPGJS që do t'ia vërtetonte të drejtën e pronësisë mbi pronën e kontestuar, të cilën, pretendon se e ka trashëguar nga babai i tij I.C.
27. Në rastin e parashtguesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vëren që DHPGJS e kishte refuzuar ankesën e tij. Arsytet për refuzim të ankesës së parashtguesit të kërkesës, DHPGJS i kishte bazuar në dispozita përkatëse të LPK-së dhe Ligjit për DHPGJS që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe përkitazi me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtguesi i kërkesës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS e kishte refuzuar ankesën e parashtguesit të kërkesës për arsye të mungesës së legjitimitetit pasiv. Ndërsa, Kolegji i Apelit i DHPGJS e kishte konsideruar kërkesën e parashtguesit të kërkesës si të tërhequr me arsyetimin se parashtguesi nuk e kishte paguar taksën gjyqësore dhe as nuk e kishte paraqitur kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore.
29. Në këtë aspekt, Gjykata do t'i referohet pjesës relevant të Aktvendimit [AC-I-17-0032-A001] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, i cili sqaron si në vijim:

“Sipas nenit 253.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore “paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksen gjyqësore të paguar. “Nenin 253.5 thotë: Në qofte se paditësi nuk e paguan taksen gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes se dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.” Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përcaktimi i taksës gjyqësore për t’ia paguar në kohen kur është paraqitur kërkesa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e kërkesës.”

“Pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksen gjyqësore siç është kërkuar nga ai, përmes njoftimit së datës 10 shkurt 2017, e cila iu është dorëzuar përfaqësuesit të ankuesit më 14 shkurt 2017, dhe ai nuk ka parashtruar kërkesë për t’u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore Kolegjit të Apelit konsideron se ankesa është tërhequr.”

30. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit i DHPGJS, [AC-I-17-0032-A001], i 26 dhjetorit 2019 është i qartë dhe arsyeton se përse kërkesa e parashtruesit ishte refuzuar.
31. Gjykata verën se refuzimi i kërkesës për shqyrtim nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJS ka të bëjë drejtpërdrejt me dështimin e parashtruesit të kërkesës që të paguajë taksen gjyqësore në pajtim me nenin 253, paragrafin 4 të LPK-së ose me dështimin e tij që të paraqesë kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore.
32. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, mutatis mutandis, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu, rastin KI56/17, parashtruese *Lumturije Murterzaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
33. Gjykata ve theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jene kryer nga Kolegji i Apelit të DHPGJS apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës me të ulet, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson me tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veproje si gjykatë e "shkalles së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: Fadil Rashiti, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 51 dhe 52, rastin KI70/11, parashtrues: Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29).

34. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktvendimit të kontestuar janë shkelur nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së.
94. Prandaj, duke u bazuar në krejt këtë që është sqaruar më lart Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me Rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 18 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama Hajrizi